

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: GEO & LAND SH.P.K., Bardhyl Qaushi, C15/11 Nr. 7, 10000, PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **25.07.2023**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik: GEO & LAND SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Operatori Ekonomik: GEO & LAND SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **20.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: GEO & LAND SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS–It PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **20.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.07.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Me këtë arsyetim ju si AK, gjegjësisht komisioni i vlerësimit së bashku me zyrtarin e prokurimit në mënyrë të hapur kanë shkelur LPP, nenin 59.4 për shkak se nuk kanë vlerësuar drejt tenderin tonë ndaj kërkesave dhe dëshmive minimale të kërkuara. Shihet qartë se kërkesa për **“1.3 Zhvillues Front-end WebGIS, Bachelor i Diplomuar në Shkenca Kompiuterike, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit”** nuk kërkon fare certifikatë për ndonjë trajnim përkatës, andaj dhe ne nuk kemi dorëzuar si të tillë. Në FTD janë shumë qartë të paraqitura kërkesat, ku për pozitën **1.1 Menaxher i projektit** kërkohet **“i certifikuar në fushën IT, GIS apo të ngjashme”**, sikurse kërkohet për pozitën **1.2 Bachelor i diplomuar në Gjeografi**, **“i njëjti duhet të jetë i certifikuar në fushën e hartave GIS”**. Mirëpo, gjithashtu qartë shihet se nuk kërkohet asnjë certifikim për pozitën në fjalë 1.3, sikurse nuk kërkohet për pozitën 1.4 dhe dy pozitat 1.5. Gjithashtu, shumë qartë është e paraqitur edhe dëshmia e kërkuar dokumentare **“Certifikata përkatëse – kopje”**, që ka të bëjë me **kërkesën përkatëse**, gjegjësisht për pozitat 1.1 dhe 1.2, dhe nuk ka të bëjë fare me pozitat tjera ku nuk ka kërkesë për certifikim. Në fakt, kjo është lehtë e kuptueshme dhe ne nuk kemi asnjë dyshim që ju si AK e keni të qartë këtë, por si duket për arsye të tjera nuk e keni vlerësuar drejt tenderin tonë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit

Në Njoftimi për Kontrate/Dosjes se tenderit, tek

Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listë të paktën këtë staf profesional:

1.3. Zhvillues Front-end WebGIS, Bachelor i Diplomuar në Shkenca Kompiuterike, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1

- Diplomati përkatës – Kopje të noterizuar;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;
- **Certifikata përkatëse – Kopje;**
- **Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1**

Tek Dëshmia 1 të Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Certifikata përkatëse për të gjithë Stafin Profesional, ku vetëm për rastin e Menaxherit të Projektit është cekur: *Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1* të Kërkesës mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, po ashtu duke u thirrur në nenin 10 të Udhëzuesit, nuk kemi mundur të kërkojmë sqarime shtesë për Certifikata përkatëse, **Ku dokumentet në fjale nuk mund të kërkojnë ne baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive; Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.**

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Arsyetimi tjetër i AK është si në vijim:

1.4. Ekspert për Gjeodezi, Bachelor i Diplomuar në Gjeodezi, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- **Certifikata përkatëse – Kopje;**

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e prezantuar, për Ekspert për Gjeodezi, kemi prezantuar z. Venhar Svika, por i njëjti ka vetëm një referencë e lëshuar nga vetë kompania GEO & LAND SH.P.K., por mungojnë certifikatat për ndonjë trajnim eventual në fushën e kërkuar, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Edhe në këtë rast, ngjashëm sikur me arsyetimin me sipër, AK ka shkelur LPP, pikërisht nenin 59.4 duke mos e vlerësuar drejt tenderin tonë. Ashtu siç shpjeguam më sipër, është shumë e qartë se për pozitën 1.4 nuk ekziston asnjë kërkesë për certifikim, rrjedhimisht nuk ekziston asnjë dëshmi për certifikim. Andaj, ne si OE nuk kemi dorëzuar certifikata për pozitën e tillë. Për sqarim më tutje po ju paraqesim në vijim kërkesat për këto pozita dhe djathtas dëshminë e kërkuar dokumentare:

Si më sipër shihen qartë kërkesat e paraqitura në kuadër të Kërkesa 1, që ka të bëjë me stafin që duhet të ketë OE, dhe si të tilla kërkesat për pozitën 1.1 dhe 1.2 kërkojnë certifikata, ndërsa pozitat 1.3, 1.4 dhe 1.5 nuk kërkojnë certifikata.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë ashtu si ne pretendimin ankimor Nr. 1, po ashtu edhe ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr.

04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit

Në Njoftimi për Kontrate/Dosjes se tenderit, tek

Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listë të paktën këtë staf profesional:

1.3. Zhvillues Front-end WebGIS, Bachelor i Diplomuar në Shkenca Kompjuterike, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**
- **Certifikata përkatëse – Kopje;**
- **Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1**

Tek Dëshmia 1 të Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Certifikata përkatëse për të gjithë Stafin Profesional, ku vetëm për rastin e Menaxherit të Projektit është cekur: *Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1* të Kërkesës mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, po ashtu duke u thirrur në nenin 10 të Udhëzuesit, nuk kemi mundur të kërkojmë sqarime shtesë për Certifikata përkatëse, **Ku dokumentet në fjale nuk mund të kërkojnë ne baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive;** Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Në letrën standarde për tenderues te eliminuar ju si AK keni paraqitur edhe një arsyetim si ne vijim:

Në bazë të Dosjes së tenderit për këtë aktivitet te prokurimit: Komuna e Rahovecit ka parashikuar shumën prej: 124,000.00 €. Në bazë të kalkulimeve vërehet se oferta e dhënë nga kompania juaj e tejkalon shumën e paraparë për këtë projekt (afërsisht: 249,863.00 Euro), sipas PZHK-së Komuna e Rahovecit ka gjithsej rrugë 562 km.

https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf

Oferta juaj për pikën 1 të Përshkrimit të Çmimeve (Digjitalizimi i rrugëve për tërë territorin e komunës Rahovecit dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes (Rrugët fushore dhe gjendja e tyre fizike, rrugët publike me kubëzim, asfaltim dhe elemente betoni), Njësia matëse: Km, Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 110.00 €, që do të thotë vetëm pika 1 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: 61,820.00 €;

Njëte është edhe për pikën 2 (Digjitalizim i trotuareve dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes, klasifikimi i ndërtimit – kubëzim, asfaltim dhe elementet e tjera), Njësia matëse: m', Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 4.00 €, që do të thotë vetëm pika 2 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: 120,000.00 €;

Sipas të dhënave të afërta në Komunën e Rahovecit janë së paku: 30,000.00 Metra gjatësi me trotuare.

Duke mbledhur shumën e totalit për pikat e lartë përmendura por edhe për pikat e tjera të ofruara nga Kompania juaj, në fund del shuma totale: 249,863.00 €, që është jashtë shumës së paraparë nga Komuna e Rahovecit

Arsyetimi më sipër është krejtësisht absurd dhe nuk ka të bëjë fare me procedurën e vlerësimit të tenderit ashtu siç parasheh LPP, neni 59.4 dhe nenet tjera respektive. Përmes këtij arsyetimi ju si AK keni devijuar krejtësisht edhe llojin e kontratës për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe gjithashtu keni devijuar krejtësisht çmimin tonë të ofertuar. **Kjo është një kontratë fikse dhe jo kontratë kornizë.** Çmimet e ofertuar në këtë tender janë çmime fikse. Në këtë rast, çmimi ynë në total i ofertuar prej 68,147.00 € është çmimi i vetëm që AK ka obligim të paguaj. Ndërsa, **çmimi jonë i poentuar është 6,880.70 €.** Si i tillë, ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, duke qenë se OE tjetër GEOCAD Group sh.p.k i cili ka ofertuar me çmimin e poentuar 571.30 € nuk plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, gjegjësisht pozitën 1.2 Bachelor i diplomuar në gjeografi me përvojë min. 3 vite pas diplomimit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit ***B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar***, ku kemi cekur:

Në bazë të Dosjes së tenderit për këtë aktivitet te prokurimit: Komuna e Rahovecit ka parashikuar shumën prej: **124,000.00 €**. Në bazë të kalkulimeve vërehet se oferta e dhënë nga kompania juaj e tejkalon shumën e paraparë për këtë projekt (afërsisht: **249,863.00 Euro**), sipas PZHK-së Komuna e Rahovecit ka gjithsej rrugë **562 km.**

https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf

Oferta juaj për pikën 1 të Përshkrimit të Çmimeve (**Digjitalizimi i rrugëve për tërë territorin e komunës Rahovecit dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes (Rrugët fushore dhe gjendja e tyre fizike, rrugët publike me kubëzim, asfaltim dhe elemente betoni**), Njësia matëse: Km, Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 110.00 €, që do të thotë vetëm pika 1 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: **61,820.00 €**;

Njëte është edhe për pikën 2 (**Digjitalizim i trotuareve dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes, klasifikimi i ndërtimit – kubëzim, asfaltim dhe elementet e tjera**), Njësia matëse: m', Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 4.00 €, që do të thotë vetëm pika 2 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: **120,000.00 €**;

Sipas të dhënave të afërta në Komunën e Rahovecit janë së paku: **30,000.00 Metra gjatësi me trotuare.**

Duke mbledhur shumën e totalit për pikat e lartë përmendura por edhe për pikat e tjera të ofruara nga Kompania juaj, në fund del shuma totale: 249,863.00 €, që është jashtë shumës së paraparë nga Komuna e Rahovecit

Çmimin e ofruara nga ana juaj, Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar duke u bazuar ne Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), ku me lart e keni te bashkangjitur Linkun, po ashtu duke u bazuar ne ofertën e juaj që për ne si AK ka qenë Oferta mbi-normalisht e lartë dhe qe e tejkalon buxhetin e për këtë aktivitet te prokurimit, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit